



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202000064/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda : Rekomandim për përmirësimin e punës për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës

MINISTRISË SË DREJTËSISË

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

**AGJENSISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË
FËMIJËVE**

AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

TIRANË

BASHKISË SARANDË

NJËSISË PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

SARANDË

Të nderuar,

Nisur nga publikimi i rastit në mediat e shkruara dhe elektronike, lidhur me dhunën e ushtruar ndaj minorenes me inicialet X.X., Avokati i Popullit kreu me iniciativë hetimin administrativ për këtë çështje. Për qëllime të hetimit, në vlerësimin dhe analizimin e provave dhe fakteve mbi ngjarjen, u inspektua Bashkia Sarandë dhe Shkolla 9-vjeçare “Adem Sheme”, pranë këtij qyteti.

Metodologjia e hetimit administrativ është bazuar në:

Së pari, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e institucioneve shtetërore në nivel vendor.

Së dyti, inspektimin në terren të të gjitha veprimeve të ndërmarra ose jo nga institucionet përgjegjëse në nivel vendor, si vijon:

- Shkolla 9-vjeçare “Adem Sheme”, Sarandë;
- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, Bashkia Sarandë;

Së treti, vlerësimin dhe analizimin e saktë të informacionit, provave, dokumentacionit dhe deklaratave të vëna në dispozicion nga institucionet e lartpërmendura veçmas, për të konstatuar dhe analizuar veprimet ose mosveprimet e ndërmarra nga ana e tyre.

Së katërti, vlerësimi i hollësishëm i të gjitha provave së bashku, për të marrë rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i institucionit të Avokatit të Popullit zhvilloi biseda me nënën dhe njerkun e të miturës.

Gjatë inspektimit në terren, konstatuam vullnetin e institucioneve përgjegjëse shtetërore në nivel vendor, për të bashkëpunuar me institucionin e Avokatit të Popullit.

Vlerësimi i rastit nëpërmjet përfaqësuesve të institucionit të edukimit parauniversitar

Ngjarja, për nga natyra është e rëndë, për vetë faktin, se në qendër të saj është një e mitur e dhunuar, por mjedisi ku manifestohet kjo dhunë, e bën rastin tepër kompleks dhe delikat.

Dhuna nuk është mjet disiplinimi dhe fëmijët duhet të mësohen të mos e pranojnë atë dhe të kërkojnë ndihmë.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social shkollor kanë për detyrë të raportojnë çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në njësitë arsimore vendore ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës. Njësia arsimore vendore, në çdo rast, kur merr dijeni për fëmijë në nevojë për mbrojtje, bën raportim në strukturat për mbrojtjen e fëmijës.

Gjithashtu, në mbështetje të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në sistemin arsimor parauniversitar respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat dhe liritë e njeriut në përgjithësi dhe, të drejtat e fëmijëve në veçanti. Kështu, theksi mbi promovimin dhe njohjen e të drejtave, kryesisht të fëmijëve, në mjedisin e institucioneve të edukimit, krijon kushtet e minimizimit dhe të referimit të hershëm të rastit të dhunës së ushtruar ndaj tyre.

E mitura, e cila ndjek klasën e tetë, nuk ka treguar asnjëherë shenja të një fëmije të dhunuar në mjedisin e saj familjar. Psikologu i shkollës në asnjë rast, nuk ka konstatuar tek e mitura X.X., tipare apo shenja të dhunës, në komunikimet me të gjatë orëve të hapura, në lidhje me tema të tilla si “sensibilizimi mbi dhunën e ushtruar në familje”, apo edhe në sjelljen e saj të përditshme në mjedisin shkollor.

Drejtuesi i institucionit arsimor, në takimet me nënën e të miturës, ka vënë re një prind mjaft të përkushtuar dhe të angazhuar, në të gjitha çështjet që kanë lidhje me vlerësimin e njohurive dhe sjelljen e të miturës gjatë orëve mësimore, ku në mjaft raste, ajo ka kërkuar madje, të jetë e pranishme në klasë, përgjatë zhvillimit të orëve mësimore.

Në mbështetje të nenit 20, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, u sigurojnë shërbim psiko-social nxënësve

dhe punonjësve të institucioneve arsimore. Shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë, për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.

Psikologu i shkollës, e ushtron profesionin e tij në 4 (katër) institucione të ndryshme arsimore:

- Shkolla 9-vjeçare “Adem Sheme”;
- Shkolla 9-vjeçare “Vrinë”;
- Shkolla 9-vjeçare “Xarrë”;
- Shkolla 9-vjeçare “5 Dëshmorët”, Ksamil.

Shkolla 9-vjeçare “Adem Sheme”, për vitin akademik 2019-2020, ka gjithsej 1131 nxënës. Ky numër i lartë i nxënësve, është tregues për një njohje të cunuar dhe jo të qartë të gjendjeve emocionale të nxënësve nga ana e psikologut. Psikologu, është prezent 1 deri 2 ditë në javë pranë kësaj shkolle. Në këtë kuptim, psikologu i shkollës e ka të pamundur identifikimin e rastit konkret, apo të rasteve të ngjashme që mund të manifestohen të të miturit në të ardhmen, si rrjedhojë e pamjaftueshmësisë së kohës së shpenzuar me nxënësit, pasi një psikolog ndjek dhe administron 4 prej shkollave 9-vjeçare të qytetit të Sarandës.

Nga vlerësimi i informacionit të administruar nga drejtori i shkollës, psikologu dhe mësuesit e lëndëve, konstatojmë, se e mitura X.X., nuk ka treguar/shfaqur shenja të një fëmije të dhunuar. Gjatë vitit shkollor 2018-2019, e mitura vlerësohej një nxënëse mesatare dhe me një numër total prej 6 (gjashtë) mungesash të justifikuara, ndërsa përgjatë 3-mujorit të parë të vitit akademik 2019-2020, e mitura ka pasur një rënie të dukshme në rezultate dhe një numër prej 12 (dymbëdhjetë) mungesash të justifikuara. Për stafin pedagogjik, ky fakt është tregues serioz i mangësive të njohurive, të mbartura nga klasa e 7, në të 8-ën.

Gjatë administrimit të të gjithë materialeve, konstatojmë se në vlerësimin e saj, sipas lëndëve, e mitura X.X., identifikohet dhe karakterizohet si një vajzë që përshkruan me fjalë të thjeshta dëshirat dhe interesat e saj, duke përdorur një gjuhë standarde, punon në grup dhe stimulon përfshirjen e anëtarëve të rinj në grupin e saj shoqëror.

Nxënësjat me inicialet X. X., ka ndjekur të gjitha vitet e saj të arsimit në të njëjtin institucion të edukimit.

Gjatë analizimit të veprimeve dhe mosveprimeve të kryera nga stafi i institucionit të arsimit parauniversitar, konstatoam se stafi pedagogjik dhe psikologu, nuk kishin mundur të identifikonin shenja (psikologjike dhe fizike) të mitura e dhunuar fizikisht, duke e pasur të pamundur menaxhimin e rastit sipas legjislacionin në fuqi dhe, në interesin më të lartë të fëmijës, për të garantuar mbrojtjen e fëmijës.

Mosidentifikimi nga kjo strukturë mjaft e rëndësishme për parandalimin dhe trajtimin me tej të rastit, sjell mosveprim në përputhje me legjislacionin në fuqi¹, mbi raportimin e menjëhershëm të tij tek strukturat përgjegjëse e, konkretisht, tek drejtuesi i shkollës, drejtuesi i zyrës arsimore të qytetit, e strukturat e mbrojtjes së fëmijës në njësitë e vetëqeverisjes vendore (PMF) apo Bashkinë Sarandë (NjMF).

Vlerësimi i rastit nëpërmjet punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 54, të Kushtetutës së RSH-së, fëmijët gëzojnë të drejta dhe mbrojtje të veçantë nga shteti. Gjithashtu, Kushtetuta parasheh mbrojtje të veçantë për fëmijët e dhunuar, të keqtrajtuar dhe, që shfrytëzohen ekonomikisht.

Në këtë frymë dhe në mbështetje të nenit 51, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, është detyrë e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, identifikimi në mënyrë proaktive i rasteve të fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet komunikimit me profesionistë nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët.

Aktiviteti dhe qëllimi i NjMF/PMF-ve përputhet me qëllimin e ligjit “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, ku për rrjedhojë fëmijët në nevojë janë përfitues të shërbimeve shoqërore².

Për sa i përket profilit ekonomik-social, familja e të miturës X.X., është përfituese nga sistemi i pikëzimit të ndihmës ekonomike, në vlerën 3900 lekë në muaj³. Gjatë vizitave të administratorit shoqëror pranë kësaj bashkie, (konkretisht 2 herë në vit), në banesën e familjes nuk janë konstatuar elementë të dhunës apo keqtrajtimit të fëmijëve nga ana e prindit, pra nënës X.X.⁴.

¹ Pika 3, e nenit 67, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

² Nenet 6, dhe 13 pika 1, të ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar.

³ 3 600 lekë pagesa bazë + 300 lekë bonus për frekuentimin e shkollës.

⁴ Pika 2, e kreut 2, të vendimit nr.597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Në veprim dhe në zbatim të detyrave funksionale, punonjësja e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe koordinatorja e dhunës, znj. X,X, më datë 22.1.2020, ora 10.00, ka kërkuar mbledhjen e GTN (Grupi Teknik Ndërsektorial) në mjediset e Bashkisë Sarandë⁵.

Në takimin e Grupit Teknik Ndërsektorial, nuk ka qënë i pranishëm punonjësi i Policisë së Shtetit, duke sjellë një mungesë bashkërendimi të punës për marrjen e të gjithave masave të nevojshme, ndërmjet strukturave përgjegjëse në nivel vendor, për garantimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës⁶.

Gjithashtu, nga administrimi i dokumentacionit ligjor, konstatoam se znj. X. X., pjesë e GTN dhe PIM (Plani Individual i Mbrojtjes), nuk ka emërimin e saj si punonjëse e mbrojtjes së fëmijëve (siç ka nënshkruar)⁷.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka më shumë se 3.000 fëmijë, duhet të ketë minimalisht një punonjës për mbrojtjen e fëmijës, kriter ligjor ky, që në rastin konkret nuk është zbatuar drejt nga organi i qeverisjes vendore⁸.

Për të miturën X.X., është hartuar dhe PIM (Plani Individual i Mbrojtjes)⁹, ku është kërkuar vendosja e të miturës në përkujdesje alternative, pranë familjes së dajës së saj, z. X.X., dhe gjatë kohës së vlefshmërisë së masës emergjente të mbrojtjes, e ëma nuk mundet të ushtrojë përgjegjësinë e saj prindërore. Është plotësuar formulari i vlerësimit fillestar, ku vlerësimi i nivelit të rrishtit është “rrezik i lartë”¹⁰. Kjo nënkupton, se me rritjen e intensitetit të rrishtit ndaj fëmijës, rrisht

⁵ GTN përbëhej nga ;

-znj. X,X, psikologe e shkollës “Adem Sheme”;
-znj.X.X, znjX,X dhe znj.X.X, përfaqësues të Bashkisë Sarandë;
-znj.X.X, përfaqësues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë;
-znj. X.X, përfaqësues i shoqatës “Jona”;
-znj. Irena Vjери, përfaqësues i organizatës “Jobis”.

⁶ Pika 1, e nenit 47, shkronja “ç” e nenit 48, dhe shkronja “d” e nenit 49, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

⁷ Në mbështetje të urdhërit nr.108, datë 14.10.2019, të kryetarit të bashkisë, z.X.X, është Punonjëse e sportelit të “Zyrës me një Ndalesë”.

⁸ Konkretisht, Bashkia Sarandë ka në përbërje të saj 5425 fëmijë, ndërsa Njësia Administrative Ksamil, pjesë e Bashkisë Sarandë, ka një numër prej 836 fëmijësh.

⁹ Pika 1, e nenit 54, të ligjit 18/2018, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

¹⁰ Fëmija rrezikon që të dëmtohet rëndë, të jetë subjekt i llojeve të ndryshme të abuzimit në mënyrë të vazhdueshme, apo të dëmtohet në mënyrë të tillë, që të vuajë nga paaftësi të përhershme, apo ti rrezikohet seriozisht mirëqënia, nëse nuk meren masa për të mbrojtur fëmijën.

gjithashtu, edhe niveli i ndërhyrjes, ku në përputhje me përcaktimet e bëra në udhëzues¹¹, niveli tretësor individual nënkupton plan individual, si dhe ndërhyrje të hartuara të studiuara, për secilin fëmijë të abuzuar fizikisht¹² apo në rrezik.

Gjetjet

Nga analiza e të gjitha veprimeve të ndërmarra për rastin në fjalë, struktura e mbrojtjes së fëmijës¹³, pranë Bashkisë Sarandë, nuk ka pasur informacion apo indicje për dhunën fizike të ushtruar ndaj të miturës, edhe pse familja ku e mitura ishte pjesë, inspektohej në mënyrë periodike nga administratorët shoqëror pranë zyrës së politikave dhe mbështetjes sociale (pjesë e saj është dhe NjMF), si një familje përfituese nga skema e ndihmës ekonomike.

Për sa më sipër, strukturat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në interesin më të lartë të tij, kanë të drejtë të kenë akses në banesën e prindit apo të personit fizik, si dhe në rezidencën e personit juridik, të cilët janë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, me qëllim që të verifikojnë situatën e fëmijës së identifikuar apo të raportuar si viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës. Kur, në bazë të rrethanave dhe fakteve është e nevojshme, strukturat e mbrojtjes së fëmijës kërkojnë mbështetje nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Mospjesëmarrja e përfaqësuesve të policisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë, në takimin e parë të GTN, të datës 22.1.2020, passjell mosmarrjen e një vendimi të duhur në zbatim të dispozitave ligjore, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës, për të garantuar së pari mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës me incialet X.X. Gjithashtu, nga administrimi i dokumentacionit ligjor, pranë Bashkisë Sarandë, konstatoam se në mbledhjen e GTN-së dhe në hartimin e PIM (Plani Individual i Mbrojtjes), kanë qënë të përfshirë punonjës, të cilët nuk e kanë emërimin si PMF, duke marrë vendime të deformatuara në lidhje me menaxhimin e rastit të të miturës viktimë e dhunës në familje.

¹¹ Udhëzimi nr.10, datë 25.2.2015, të Ministrisë së Mirqënies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, Ministrisë të Brendshëm, Ministrisë të Shëndetësisë “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik, për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës” të ndryshuar.

¹² Abuzim fizik është çdo tentative ose çdo dëmtim fizik, apo plagosje e fëmijës, të cilat nuk janë aksidentale dhe synojnë të shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, sado të lehta qofshin këto. Në abuzim fizik përfshihen forma të tilla, si; rrahja, tortura, shkundja/ shtytja me forcë, djegia, goditja (shuplakë ose shkelm), pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, detyrimi me forcë, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim.

¹³ Pikat “1”, “2” dhe “3”, të nenit 62, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Në strukturën e mbrojtjes së fëmijëve në Bashkinë Sarandë, nuk ka numër të mjaftueshëm punonjësish për të menaxhuar raste të fëmijëve viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës. Në këtë Bashki nuk është respektuar kriteri ligjor mbi caktimin e numrit të punonjësve në bazë të numrit të përgjithshëm të fëmijëve¹⁴.

Në funksion të zbatimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, për t'i ofruar një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe në mbështetje të pikës 1, të nenit 23, të ligjit nr.18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", fëmija ka të drejtë të mbrohet ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, pavarësisht vendit ku kryhet, pasi mbrojtja e jetës së fëmijës është një e drejtë e garantuar me ligj.

Në këtë kuptim, në frymën edhe të legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës dhe administrimit të drejtësisë penale për të mitur, drejt një qasjeje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, për zbatim korrekt të këtij legjislacioni, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre dhe, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21 dhe 24, shkronja "a", të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave, për emërimin të një punonjësi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Bashkinë Sarandë.
- Marrjen e masave, për një bashkërendim ndërmjet strukturave përgjegjëse në nivel vendor (Bashkia Sarandë, Komisariati i Policisë Sarandë), për garantimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve.
- Marrjen e masave nga ministritë e linjës për informimin e të gjitha strukturave përgjegjëse për ushtrimin e detyrimeve dhe përgjegjësive në zbatim e legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës dhe Kodit të Drejtësisë penale për të Miturit.
- Marrjen e masave për trajnimin dhe kualifikimin e stafeve përkatëse sipas fushave të veprimtarisë, si; në arsim, bashki, polici, shëndetësi etj. për të rritur

¹⁴ Pika 2, të nenit 50, të ligjit nr.18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

- kapacitetet ndaj një identifikimi më proaktiv të rasteve të fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje.
- Marrjen e masave për ndryshimin e legjislacionit që rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive, për përcaktimin e rregullave më të detajuara, për sa i përket trajtimit të çështjeve të abuzimit/dhunës tek të miturit.

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës, drejt qasjes së bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA